

Revista H^{NA}



VOLUMI 3

Çka është Revista HËNA ?

Revista "HËNA" është krijuar me qëllim të avokimit për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë, përmes së cilës promovohen aktivitetet që fëmijët realizojnë në kuadër të HANDIKOS, duke përfshirë komunën e Prishtinës, Ferizajt, Gjakovës dhe Mitrovicës. Revista përditësohet dhe publikohet në çdo tre muaj.



HËNA – Grup jo formal avokues i fëmijëve me aftësi të kufizuara, i cili që nga themelimi ka për mision të garantoj të drejtat e fëmijëve për fëmijët me aftësi të kufizuara. HËNA përfaqëson nevojat e fëmijëve në nivel lokal dhe qendror, për më tepër është aktivisht i përfshirë në të gjitha proceset e HANDIKOS.

Çka është HANDIKOS?

HANDIKOS është organizatë jo qeveritare, që për mision ka të arrijë ndryshime pozitive dhe të qëndrueshme në jetën e personave me aftësi të kufizuara, përmes përfaqësimit, mbrojtjes së të drejtave dhe përkrahjes së tyre. Pjesëmarrja; Punësimi; Edukimi & Trajnimi; Mirëqenia Sociale; Shëndeti janë objektivat strategjike të HANDIKOS të cilat synon t'i arrij përmes avokimit dhe ofrimit të shërbimeve cilësore për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara.



Më duaj,
më mbroj!



Një, dy, fitova!



Smile, shine. Be you.



Qendrat e Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi - **RBB**

RBB - Prishtinë

- **21 (8V, 13D) fëmijë me aftësi të kufizuara** kanë pranuar mbështetje individuale në zhvillimin e tyre fizik, psikosocial dhe psikologjik;
- **21 prindër** të fëmijëve me aftësi të kufizuara kanë ngritur kapacitetet në mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve të tyre;
- **18 prindër** të fëmijëve me aftësi të kufizuara janë mbështetur me seanca individuale psikologjike dhe psikosociale;
- **11 (8F, 3M)** persona të rritur me aftësi të kufizuara janë mbështetur përmes takimeve individuale me karakter psikosocial;
- **25 (18F, 7M)** persona me aftësi të kufizuara janë mbështetur përmes vizitave në shtëpi;
- Janë realizuar **6 takime** mbështetëse me 30 (13F, 17M) të rinjë me aftësi të kufizuara;
- **8 persona** me aftësi të kufizuara dhe familjarë të tyre janë mbështetur për aplikim në skema pensionale;
- Janë shpërndarë më shumë se **220 pajisje ndihmëse** për persona me aftësi të kufizuara, ndër to karroca, paterica, shëtitore, shtretër ortopedik etj.
- Janë shpërndarë **50 pako** ushqimore dhe higjienike për 50 familje.

RBB - Mitrovicë

- Një (1) person** ka filluar punën pas periudhës provuese në Diakonie; ←
- Janë ofruar **10 pako** ushqimore (5 për nëna kryefamiljare dhe 5 për anëtarë të HANDIKOS); ←
- Janë realizuar **gjashtë (6) takime** të grupeve të vetë-përkrahjes me 12 të rinj (7 M & 5 F) me aftësi të kufizuara; ←
- Janë realizuar dy trajnime tre ditore me **15 të rinj** (10M & 5F) me aftësi të kufizuara rreth fuqizimit në punësim; ←
- Janë shpërndarë **pesë (5) pajisje ndihmëse** për persona me aftësi të kufizuara; ←
- Në suaza të vazhdueshme janë mbështetur **fëmijët dhe prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara** me anë të këshillave juridike. ←

RBB - Ferizaj

- **36 (12V, 24D) fëmijë me aftësi të kufizuara** kanë pranuar mbështetje individuale dhe grupore në zhvillimin e tyre fizik, psikosocial dhe edukim joformal;
- **34 fëmijë me aftësi të kufizuara (11V- 23D)** kanë përfituar nga aktivitetet sociale dhe argëtuese që promovojnë gjithpërfshirjen e fëmijëve dhe pavarësimin e tyre;
- **72 (42M, 30F) prindër** të fëmijëve janë mbështetur me këshilla psikologjike;
- **2 (1M, 1F) familje** të fëmijëve me aftësi të kufizuara janë asistuar përgjatë aplikimit për pension të familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara;
- Janë identifikuar **4 fëmijë me aftësi të kufizuara** (2F dhe 2M) raste të reja që marrin shërbime në Handikos Ferizaj
- **12 fëmijë me aftësi të kufizuara (4V, 8D)** janë referuar për vlerësim/rivlerësim në ekipën vlerësuese komunale.

RBB - Gjakovë

17 (10M dhe 7F) persona kanë përfituar nga shërbimet e rregullta fizioterapeutike dhe alternativa tjera të rehabilitimit në QRBB dhe familje, me gjithsej 153 sesione. ←

5 (2M dhe 3F) persona kanë përfituar shërbime të këshillimit dhe mbështetjes psiko-sociale nga 25 vizita në familje (20 sesione); 5 përfitues në qendër(2M-3F) me 75 sesione; Takime grupore të prindërve (20F); Në qendër 7 takime me 49 sesione. ←

18 (14M dhe 4F) në familje dhe QRBB përfitues fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara të shërbimeve logopedike, me 152 sesione ←

20 fëmijë (13D dhe 7V) kanë përfituar nga shërbimet e edukimit joformal, përmes 222 sesioneve. ←

25 (14M dhe 11F) kanë përfituar nga 16 aktivitete kreative dhe rekreative, aktivitete ndërgjegjësuere, socializuese dhe trajnime për ngritje të kapaciteteve të stafit dhe anëtarëve, me gjithsej 244 sesione ←

51(30M dhe 21F) fëmijë dhe të rritur kanë përfituar nga pajisjet ndihmëse ←

13 (9M dhe 4F) persona janë referuar për plotësimin e dokumentacionit për asistencë sociale ←

Janë vizituar **40 Shkolla fillore** (takim me drejtorë, mësues dhe koordinatorë të cilësisë) ←



Storie Suksesi

Fletënotimi komunitar nxiti përmirësimin e qasjes në QKMF Gjakovë



Institucionet primare për marrjen e shërbimeve mjekësore, siç janë spitalet apo qendrat e mjekësisë familjare në Kosovë vazhdojnë të përballen me sfida në ofrimin e qasjes infrastrukture dhe me standarde për personat me aftësi të kufizuara. Njëjtë ishte deri në vitin e kaluar edhe në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Gjakovë, ku barrierë kryesore rezultonte mungesa e ashensorit për lëvizje poshtë-lartë.



**Funksionalizimi i ashensorit,
QKMF - Gjakovë**



Mirëpo falë procesit të Fletënotimit Komunitar, në po këtë qendër është arritur që përgjatë vitit 2020 të ndërtohet dhe funksionalizohet ashensori, pa të cilin pengohej marrja e shërbimeve sidomos në repartin e Stomatologjisë i cili gjendet në katin e II-të të ndërtesës.

Ky intervenim nuk ua lehtësoi lëvizjen vetëm personave me aftësi të kufizuara, por edhe prindërve të fëmijëve, të moshuarve apo cilit do grup tjetër që tashmë shërbimet e nevojshme kanë mundësinë t'i pranojnë po në Qendrën Kryesore për Mjekësi Familjare në këtë qytet.

E përshtypjen e saj pozitive për këtë lehtësirë e jep edhe Lumturija Vorfi, prind i një fëmije me aftësi të kufizuara në Gjakovë e cila tregon se më herët ishte detyruar ta barte fëmijën në duar për t'u ngjitur lartë.

"Shumë ia ka lehtësuar fëmijës tim qasjen ky ashensor. Çdo lehtësim në qarkullim për ta është i mirëseardhur. Prandaj kur shoh këso lloj iniciativash për të mirë të tyre apo për lehtësim të neve familjarëve për t'i dërguar diku, është shumë e mirëpritur", thotë Lumturija. Ajo tutje tregon se në raste të caktuara ishte detyruar të frekuentonte edhe ordianca private të Stomatologjisë, na pamundësi për të marrë shërbimin pa pengesa në qasje në QKMF. "Jemi detyruar të shkojmë madje në ordinancë private, shkaku i barrierës në insitucionin publik mjekësor".

Lumturija ka edhe një mesazh për gjitha institucionet relevante, në mënyrë që të gjithë qytetarët të trajtohen barabartë kur bëhet fjalë për të drejtën elementare, lëvizjen e lirë. *"Çdo vend që ekziston të bëhet me qasje më të lehtë për çdo person me aftësi të kufizuara. Është çështje njerëzore, jo obligim".*



Fletënotimi Komunitar është instrument i llogaridhënies sociale i cili bashkon qytetarët dhe ofruesit e shërbimeve në identifikimin e çështjeve të cilat ua vështirësojnë fëmijëve me aftësi të kufizuara qasjen në shërbime të ndryshme, si shëndetësi, edukim, mirëqenie dhe fusha të tjera.

Bashkërisht, mund të bëjmë ndryshime në komunitetin tonë.

Ky proces implementohet nga HANDIKOS në partneritet me Save the Children në Kosovë, në kuadër të projektit "Promovimi i parandalimit të dhunës ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë në të gjitha mjediset", financuar nga SIDA suedeze.

Bashkërisht, mund të bëjmë ndryshime në komunitetin tonë.

***Ka më shumë rëndësi ajo që
ju bëni për fëmijën tuaj sesa
ajo që ju ndjeni për të.***





Kohëve të fundit ushqyerja e shëndetshme është bërë temë e shumë studimeve të cilat kanë treguar prej më afër ndikimin e saj në shëndetin tonë. Është parë se cilësia e të ushqyerit në fëmijëri e ndikon ndjeshëm zhvillimin e fëmijës.

Për fëmijët me aftësi të kufizuara, ushqyerja e shëndetshme ka rëndësi tejet të madhe në forcimin e imunitetit, parandalimin e gjendjeve shoqëruese, parandalimin e peshës së tepërt apo edhe menaxhimin e peshës së ulët trupore.

Me prezencën e ushqimeve të shpejta në treg, ushqimet bio dhe të shëndetshme nuk janë zakonisht zgjedhja e parë e një fëmije. Ndaj, ju mund të nxitni fëmijët tuaj të ushqehen shëndetshëm përmes mënyrave të ndryshme, si:



Bëhuni model për të - fëmijët imitojnë dhe riprodhojnë sjelljet e të rriturve përreth, ndaj nëse dëshirojmë të ndryshojmë diçka tek fëmija, duhet të nisim nga vetja;



Shpjegoni benefitet e ushqyerjes së shëndetshme- kur fëmija kupton se si sheqeri dhe yndyrërat ndikojnë në trupin tij/saj, gjasat janë më të mëdha që të fillojë të adaptojë një stil më të shëndetshëm jetese sesa nëse vetëm i ndaloni ushqime të caktuara;





Servoni ushqime argëtuese për fëmijë- prisni ushqimet në forma të ndryshme duke formuar kafshë apo figura të tjera atraktive për fëmijë;



Bëjeni blerjen e ushqimeve një përvojë argëtuese për fëmijët- kërkoni nga ta të zgjedhin ushqimet si frutat apo perimet në bazë të ngjyrave apo karakteristikave të tjera;



Përfshini fëmijët në përgatitjen e vakteve ushqimore- ata do jenë më të gatshëm të konsumojnë diçka të cilën e kanë gatuar vetë. Për më tepër, koha e shpenzuar bashkë mund të ndikojë pozitivisht në marrëdhënien tuaj me fëmijën;



Bëjeni blerjen e ushqimeve një përvojë argëtuese për fëmijët- kërkoni nga ta të zgjedhin ushqimet si frutat apo perimet në bazë të ngjyrave apo karakteristikave të tjera;



Mos ndaloni plotësisht ëmbëlsirat- rregulla të tilla mund të rrisin dëshirën e fëmijës për të konsumuar sheqer;



Prezantoni ushqimet e reja në kombinim me ato të preferuarat- p.sh. shtoni perime të reja në supën e preferuar të fëmijës.




Të gjithë kemi lindur të
ndryshëm,
në atë se si dukemi, në
atë se çfarë themi.

Vijmë nga vende të
ndryshme të botës,
qofshim djalë apo
vajzë

jemi të madhësive e ngjyrave të ndryshme,
qofshim me aftësi të kufizuar apo jo, të
gjërave që i pëlqejmë,
e ato çfarë i bëjmë

Sa mirë që bota
funksionon në këtë
mënyrë
Me plot drita, me plot
ngjyrë

Se po të ishim të gjithë
njësoj, ti nuk do të
bëheshe ti, e unë s'do të
bëhesha unë!



Një përqaftim të bën të
ndihesh të lumtur gjatë
gjithë ditës.



Të drejtat

E drejta e qasjes fizike në institucionet dhe hapësirat publike

Sot, në Kosovë ndërtimet e reja si objektet arsimore institucionale, rrugët, trotualet, mjetet e transportit e shumë të tjera, megjithë ndryshimet e pakta, ende mbesin të papërshtatshme për personat me aftësi të kufizuara, përkundër faktit të ekzistimit të Ligjit Nr. 04/L – 110 për ndërtim, i cili ndër tjera rregullon qasjen dhe përshtatjen e objekteve, rrugëve dhe ambientit për personat me aftësi të kufizuara, të specifikuara në Udhëzimin Administrativ Nr. 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara.



Ky udhëzim administrativ ka **dispozita obliguese** për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, që nga fazat e projekteve deri tek pranimet teknike të objekteve ndërtimore. gjithashtu, ka dispozita edhe për përshtatjen e objekteve ekzistuese, duke obliguar të gjithë përgjegjësit e institucioneve dhe subjekteve tjera që ofrojnë shërbime për publikun, të përshtatin objektet për lehtësim të qasjes për personat me aftësi të kufizuara.

Në nenin 9 të udhëzimit Administrativ Nr. 33/2007 theksohet se

→ “Për nevojat e qasjes në sipërfaqe me lartësi të ndryshme, në të cilat lëvizin PAK mund të shfrytëzohen këto elemente të nevojshme për qasje: rampa, shkallët, ashensori, platforma vertikale ngritëse dhe platforma e pjerrët ngritëse palosëse”.



Për detajet se kur dhe si duhet ndërtuar këto elemente mund të informoheni në linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7480>

Prindërimi

Ngrohtësia dhe struktura si baza të Disiplinës Pozitive

Ngrohtësia dhe struktura konsiderohen dy nga mjetet më të rëndësishme për të ndërtuar shkathtësitë tuaja të disiplinimit pozitiv. Kombinimi i tyre mund të përdoret gjatë gjithë kohës së zhvillimit të fëmijës nga foshnjëria e deri në moshën e pjekurisë së hershme dhe ndihmon prindërit në arritjen e qëllimeve afatgjate me fëmijët e tyre.

Ngrohtësia prindërore është ofrimi i sigurisë emocionale, dashuria e pakushtëzuar, shumë përqaftime, lavdërime, inkurajim dhe rehati që mund t'u ofrojmë fëmijëve tanë.

Cilat janë disa nga format e prindërimit pozitiv?

Ngrohtësia prindërore është ofrimi i sigurisë emocionale, dashuria e pakushtëzuar, shumë përqaftime, lavdërime, inkurajim dhe rehati që mund t'u ofrojmë fëmijëve tanë.



Pse është e rëndësishme ngrohtësia prindërore?

Një figurë e dashur prindërore ndikon në shëndetin e fëmijës tuaj gjatë gjithë jetës. Duke u thënë atyre “Të Dua” madje edhe kur bëjnë gabime, duke e parë situatën edhe nga këndvështrimi i tyre dhe duke i vlerësuar ata, ne ofrojmë një klimë të ngrohtë familjare dhe inkurajojmë përmbushjen e qëllimeve afatshkurta dhe mësimin e vlerave afatgjata.

Çfarë është struktura prindërore?

Me anë të strukturës prindërore ju jepni udhëzime dhe pritshmëri të qarta për sjelljen e fëmijëve tuaj duke u dhënë informata që të kenë sukses herën e ardhshme. Në këtë rol, ju vendosni kufij dhe përdorni disiplinën pozitive, u ofroni mbështetje për t’i ndihmuar ata që të kenë sukses, inkurajoni të menduarit e tyre të pavarur dhe u mësoni negocimin.

Pse është e rëndësishme struktura prindërore?

Kur ju nuk jeni aty, struktura i siguron fëmijës mjetet, të cilat i nevojiten për t’i zgjidhur problemet duke u ofruar një ndjenjë sigurie dhe kontrolli dhe gjithashtu duke ndihmuar në krijimin e zakoneve të shëndetshme që zgjasin deri në moshën e rritur.

Parandalimi i dhunës

Çështja e abuzimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara ka një histori të trishtë e cila shtrihet që nga kohët më të hershme.



Çka duhet të dimë rreth abuzimit?

- Globalisht vlerësohet se deri në 1 miliard fëmijë të moshës 2-17 vjeç kanë përjetuar ndonjë formë të dhunës fizike, seksuale, emocionale apo të neglizhimit;
- Çdo i 4-ti i rritur ka qenë i abuzuar fizikisht si fëmijë; 25% e të rinjve janë ngacmuar muajin e kaluar;
- Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë 3.7 herë më shumë gjasa të përjetojnë dhunë sesa fëmijët pa aftësi të kufizuara;
- Në shumicën e vendeve të botës, çdo dy në tre fëmijë i nënshtrohen disiplinave të dhunshme nga kujdestarët e tyre.



Si qëndron Kosova?

Së fundmi, Policia e Kosovës apo Qendra për Punë Sociale kanë filluar të grumbullojnë të dhëna të rasteve të dhunës tek fëmijët me aftësi të kufizuara, një hap ky shumë i rëndësishëm drejt identifikimit dhe raportimit të rasteve të reja .

- Sipas statistikave, vetëm përgjatë 4 muajve të parë të vitit 2021 janë regjistruar gjithsej 118 (84V, 34d) raste të fëmijëve të përfshirë në dhunë në familje, 4 (3V, 1D) nga të cilët me aftësi të kufizuara.



Referencat

- 1 www.who.int/health-topics/violence-against-children
- 2 data.unicef.org/topic/child-protection/violence/violent-discipline
- 3 [www.thelancet.com/journals/lancet/article/PIIS0140-6736\(12\)60692-8/fulltext](http://www.thelancet.com/journals/lancet/article/PIIS0140-6736(12)60692-8/fulltext)
- 4 Policia e Kosovës



Hulumtime/Publikime

Raporti- Mbrojtja e fëmijëve

HANDIKOS për 5 vite me radhë përmes projektit “Promovimi i parandalimit të dhunës ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha mjediset” ka punuar drejt krijimit të mjediseve të sigurta dhe pa dhunë për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Për të kuptuar më qartë rezultatet dhe ndikimin e këtij projekti është realizuar një raport vlerësues, i cili ndër të tjera ka theksuar se:

- Projekti ka ndikuar në inicimin e dy proceseve të rëndësishme në nivel nacional që adresojnë në mënyrë direkte dhunën ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara:

- Rishikimi i Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje për të integruar nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara; dhe
- Disagregimi i databazës për identifikim të rasteve të dhunës në familje, duke përfshirë numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përfshirë në dhunë në familje.



Rreth 6000 persona, nga ta ofrues të shërbimeve, prindër dhe fëmijë me aftësi të kufizuara kanë përfituar nga intervenimet e projektit në funksion të parandalimit të dhunës, ku nga ta specifikisht:

- 1840 ofrues të shërbimeve kanë ngritur kapacitetet në teknikat e komunikimit me fëmijë me aftësi të kufizuara; në të kuptuarit e specifikave të fëmijëve me AK në Procedurat Standarde të Veprimit; disiplinën pozitive; si dhe njohjen, raportimin dhe reagimin ndaj situatave të dhunës.
- 3600 nxënës të shkollave janë vetëdijësuar për të qenë pranues dhe jo paragjykses ndaj fëmijëve me AK, përdorues 260 fëmijë me AK janë vetëdijësuar mbi njohjen, refuzimin dhe largimin nga situatat potencialisht të dhunshme dhe të rrezikshme për ta.

- 275 prindër kanë ngritur kapacitetet e tyre në përdorimin e praktikave pozitive në prindërimin e përditshëm.



Projekti ka kontribuar në hartimin dhe zbatimin e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve në kuadër të HANDIKOS, dokument ky i cili është bërë pjesë qenësore e rekrutimit të sigurt si dhe funksionimit në përgjithësi të organizatës dhe rrjetit.

Lidhur me intervenimet e realizuara në kuadër të projektit, përfitues të ndryshëm kanë ofruar feedbackun e tyre.

Albina Hoxha, edukatore në SOS
Fshatrat e Fëmijëve

Këto trajnime jo vetëm që na kanë ndihmuar të kuptojmë më mirë fëmijët tanë dhe të dimë si të sillemi me ta, por në të njëjtën kohë na kanë ndihmuar edhe vetë ne si nëna e si prindër që të menaxhojmë më mirë stresin dhe zemërimin tonë, të jemi më të qetë përballë fëmijëve pasi tani i kuptojmë më mirë edhe nevojat e tyre

Albina Hoxha, edukatore në SOS
Fshatrat e Fëmijëve

Këto informacione kanë qenë shumë të nevojshme pasi na kanë ndihmuar të përmirësojmë qasjen tonë jo vetëm ndaj fëmijëve me të cilët punojmë, por edhe në detyrën tonë si prindër, në familjet tona”.

Mendoj që trajnimet e parandalimit të dhunës duhet të bëhen më shpesh me fëmijët, në mënyrë që të gjithë fëmijët të jenë të sigurtë”.

Muhamet Ismajli, fëmijë
nga Ferizaj

Sport dhe rekreacion

E drejta e lojës është një nga të drejtat bazike të fëmijëve. Të qenurit aktiv është pjesë shumë e rëndësishme e cila mundësohet nëpërmjet pjesëmarrjes dhe angazhimit në lojëra. Shumica e lojërave tradicionale (pingpong, tenis, basketboll, futboll, volejboll, etj.) mund të luhen edhe nga fëmijët me aftësi të kufizuara; e gjitha çfarë kërkohet është të bëhen modifikime në: mënyrën e organizimit; ndryshimit të rregullave; ofrimit të pajisjeve shtesë; si dhe në përshtatjen e mjedisit. Më poshtë i gjeni disa lojëra të cilat mund të luhen nga të gjithë:

Hokej në ajër- ping pong

Kjo lojë është kombinim i rregullave të air-hockey dhe pingpong-ut. Rrjeta e pingpongut ngrihet pak lart dhe në vend se të luhet për nga lart, lojtarët duhet të gjuajnë/rrëshqasin topin nën rrjetë në pjesën e tavolinës së ekipit tjetër. Mund të luajnë dy ekipe me nga 4 lojtarë (në mënyrë që të sigurohen të gjitha qoshet e tavolinës).



Sfida e stafetës

Kjo lojë mund të luhet në dy ose më shumë grupe, ku në secilin grup janë të vendosura portat. Vrapuesit e të dyja grupeve (edhe përdoruesit e karrocës) nisen paralelisht duke kaluar nëpër porta, duke shkuar rreth konit të fundit dhe duke u kthyer në të njëjtën mënyrë. Loja mbaron kur të gjithë vrapuesit kanë përfunduar stafetën dhe grup fitues shpallet ai vrapuesi i të cilit është kthyer i pari.



Volej-balon

Ngjashëm si në volejboll, qëllimi është të hudhet topi mbi rrjetë, por që në vend të topit mund të përdoret baloni apo reketa e badmintonit. Lojtarët mund t'i ndajnë detyrat, ku njëri është sulmuesi, ai i cili godet balonin mbi rrjetë dhe shoku i ekipit i cili vendos balonën tek sulmuesi për goditje.



Ky produkt është financuar
nga **Qeveria e Suedisë.**
Përgjegjësia për përmbajtjen i
takon tërësisht **HANDIKOS.**
Qeveria e Suedisë jo
domosdoshmërisht ndan të
njëjtat pikëpamje.

Implementuar nga:



Mbështetur nga:

